

LORETA LOLI

**PERSONAZHI LETRAR PËRMES KARIKATURËS
- RASTI I NOVELËS *DR. GJËLPËRA ZBULON RËNJËT
E DRAMËS SË MAMURRASIT***

Për kritikun përdorimi më i zakonshëm i termit *imazh* është ai që bën subjektiven të duket objektive¹. Na intereson momenti kur në veprën letrare sillet imazhi i një personi konkret nga një realitet historik i caktuar dhe se si më pas imazhi, si përfaqësimi i këtij personi, realizon në vepër identifikimin me të.

Çfarë i interesonte Faik Konicës të sillte përmes personazhit letrar të Ministrit Salembozë në veprën *Dr. Gjëlpëra zbulon rënjët e dramës së Mamurrasit*? Dhe për më tepër, çfarë i interesonte Konicës që të sillte përmes karikaturës së Ministrit Salembozë? Përse ai e dublon imazhin, si proces përfaqësimi, për të njëjtin person?

Përgjigjet e pyetjeve do ta na i japë analiza tekstuale në vazhdim, megjithatë, paraprakisht, mund të pohojmë se karikatura i shërben Konicës për të kryer identifikimin e plotë mes personit real dhe personazhit letrar. Nga ana tjetër, karikatura i shërben kritikut të veprës së Konicës për të gjurmuar dhe interpretuar mënyrat se si ndodh identifikimi i plotë i personit real, ndryshe Ahmed Zogut, në personazhin letrar, ndryshe Ministrit Salembozë, si dhe kuptimet që gjenerojnë prej kësaj marrëdhënieje figurimi.

Si editor dhe botues i revistës “Albania” dhe, më pas, editor i gazetës “Dielli”, Konicës nuk i mjaftoi vetëm fjala dhe letërsia si fiksjon për ta transmetuar të plotë imazhin që kishte për dukuri, ngjarje, momente a personazhe të caktuara shqiptare, ai përdori për këto raste, si “shtojcë” të veprës karikaturën, për të konkretizuar vizualisht përmes imazhit mendimin e shprehur në ato pjesë. Është e shpeshtë tek ky shkrimtar që personazhet t’i shëtisë sa në njërin tekst në tjetrin dhe sa në njërin karikaturë në tjetrën, aq sa kur lexon vetëm titullin e një shkrimi apo vetëm

¹ *The Routledge Dictionary of Literary Terms*. Routledge Press, London and New York, 2006, f. 115.

diçiturën e një karikature, menjëherë sheh dhe kupton në fund të leximit se diçka e re thuhet për personazhin, një sqarim më tepër ndërfitet nga Konica në kontekstin që jep etj. Këto, të gjitha së bashku, falë marrëdhënieve intertekstuale, që formojnë, marrin vlerë të shtuar në analizën e përmbajtjeve dhe lidhjeve të pjesëve me njëra-tjetrën.

Fjala karikaturë rrjedh nga *caricare* (italisht) dhe ka kuptimin “për të ngarkuar”, ose diçka të përafërt me “ngarkesën”. Kështu, karikatura në thelb do të thotë një “portret i ngarkuar”, shtrembërimi i qëllimshëm i tipareve, karakteristikave ose ligjëritit të një personi, ose të një ideje, është një ilustrim humoristik, që tepron ose shtrembëron thelbin e thjeshtë të një personi ose sendi për të krijuar një ngjashmëri identifikuese të lehtë pamore. Madje, sipas profesionistëve të kësaj fushe arti, sugjerohet të mos vizatohen *trillimet e karaktereve imagjinare, të cilat nuk posedojnë grupe objektive të karakteristikave fizionomike për të nxjerrë në referencë...*, karikatura i referohet vetëm njerëzve me pamje të vërtetë të jetës.²

Nëse do t’u referohemi konkretisht fjalorëve të termave letrarë³ shohim se ata, për të përkufizuar karikaturën, nisen duke shpjeguar së pari parodinë, pastishin, burleskun, si teknika shumë të përdorura në letërsi, për t’u hedhur më pas në sqarimin e termit. Kuptohet se midis karikaturës dhe parodisë, karikaturës dhe pastishit e të tjerave teknika letrare ka shumë afri, por, ndërkohë, pranohet edhe një diferencë e prekshme mes tyre. Nëse format e para (parodia, pastishi etj.) nuk janë origjinale në kuptimin e ekskluzivitetit të tekstit, sepse krijohen duke iu referuar dhe praktikisht duke e përdorur një tekst të krijuar më parë, të cilin e imitojnë në stil, e rimarrin në formën e citateve etj., me qëllime të qarta për të krijuar efekte të caktuara komike apo të një niveli të caktuar kritik, në rastin e karikaturës, si formë e artit përmes vizatimit, origjinaliteti në tekst është i paprekur, në kuptimin që nuk është një vepër e krijuar më parë.

Karikaturën në përgjithësi dhe karikaturën politike e shoqërore me funksion intertekstual në veçanti, Konica e përdori dhe e zhvilloi fuqishëm në gazetën “Dielli”.⁴ Për këtë ai bashkëpunoi me karikaturistin e njohur amerikan Frank E. Davidson. Tekstin e diçiturave e plotësonte vetë

² Sipas specialistit të karikaturës në Shkollën e Arteve Vizuale në New York, Sam Viviano, “karikatura i referohet vetëm njerëzve me pamje të vërtetë të jetës”.

³ Në fjalorin e termave letrare, *Literary Terms*, përgatitur nga Peter Childs dhe Roger Fowler, në zërin Caricature thuhet: Shih tek zëri Parody.

⁴ Përsëri është Konica i pari ai që e emërtoi teknikën e karikaturës si cartoon dhe e solli për botën shqiptare në bashkëkohësi me realitetin evropian dhe atë amerikan.

Konica⁵, por kontributi i tij ishte edhe në ndërtimin e imazhit që realizohej teknikisht nga z. Davidson. Dallohet “dora” e Konicës teksa shikon se si personazhet e veprave të tij sillen në karikaturë me detajet personifikuese që pena e shkrimtarit ua fiksoi në tekstet letrare, duke e vazhduar kështu jetën fiksionale edhe në hapësirat e imazhit.

Teksa shohim nëpër karikatura të ndryshme doktorët anadollakë apo Ministrin Salembosa, ne, gjithashtu, kujtojmë dhe njohim personazhet letrare me pamjen e tyre të shëmtuar, dritëhijet e errëta që i mbulojnë, portretet groteske, ku shquhet mungesa e dhëmbëve apo ngërdheshjet që u vijnë për shkak të injorancës që kanë, vështirimet e humbura, higjienën e munguar etj., sikundër, nga ana tjetër, në personazhet e protagonistëve që Konica na ka dhënë në prozë, si për shembull në tregimin *Lulia e malevet*, tek personazhi i Toskua-s gjejmë kostumin e bukur kombëtar shqiptar, fustanellën dhe kësulën, lexojmë në portret hijeshinë e shqiptarit, ndeshim në mustaqet e gjata, identifikuese të burrërisë, vështirimin e thellë dhe estetikën e bukur të qëndrimit krenar e sfidues, që përçojnë së bashku kënaqësi dhe optimizëm për racën shqiptare.

Për të analizuar dukurinë e intertekstualitetit në veprën letrare dhe në karikaturë, si një formë tjetër shprehjeje, mund të marrim në analizë praninë e motiveve të tregimit *Një ambasadë e Zulluve në Paris* apo të novelës *Dr. Gjëlpera zbulon rënjet e dramës së Mamurrasit*, të cilat i gjejmë lehtësisht të sjella në shumicën e karikaturave tek gazeta “Dielli”, gjatë viteve 1922-1926. Përmendim rastin e personazhit të Denizullu – Serpes, kategorinë e Levantinëve në Shqipëri, apo sfondin kur Dr. Gjëlpera takohet me ambientin e prapambetur shqiptar etj.

Më së shumti përdoret forma e aluzionit si intertekst, ndërsa e gjejmë, por më pak, edhe formën e citatit, atëherë kur përmenden emrat e personazheve, apo kur shkruhet shkoqur kategoria e Levantinëve.

Për të konkretizuar analizën tekstore, më poshtë, shembujt nga diçiturat e karikaturave do të sillen të plotë dhe të shoqëruar me imazhin përkatës, sepse kështu leximi intertekstual me veprën letrare do të jetë më i thjeshtë për t’u bërë. Renditjen e tyre e kemi bërë në respektim të kohës së botimit të prozave letrare dhe jo sipas kohës së botimit të vetë karikaturave, d.m.th., së pari vijnë gjurmët intertekstuale me tregimin *Një*

⁵ KONICA, Faik. (2013). *Karikatura në gazetën “Dielli” (20.5.1922 – 3.9.1926)* (Mblodhi, përgatiti dhe pajisi me shënime Eftim Dodona). Prishtinë. Shtëpia Botuese Faik Konica, f. 20.

ambasadë e Zulluve në Paris dhe më pas ato me novelën Dr. Gjëlpëra zbulon rënjet e dramës së Mamurrasit.

I. “Dielli”, Cartoon – Nr. 69, datë 16 qershor 1925.
“His excellency the new envoy extraordinary”



“His excellency the new envoy extraordinary”

(A very extraordinary one!) Presenting his ‘lettres de créance’ [(I dërguari i ri i jashtëzakonshëm). (Vërtet i jashtëzakonshëm) po paraqit letrat kredenciale).]

Qeveria e re e Shqipërisë është një qeveri e Shqipërisë por jo një qeveri e shqipëtarëve, duke vazhduar politikën e saj që e bën Shqipërinë një shtet që e qesh gjithë bota, ka filluar të mbushi legatat dhe konsullatat Shqiptare me emrat të nxjerra nga gjirizi. P.sh. në një shtet u dërgua një person i kërkuar nga policia për bashkëpunim në një vrasje të bujshme. Në një shtet tjetër u dërgua një person i cili gjithë jetën e vet është tallur me Shqipërinë dhe nuk mund të shkruajë dot dhjetë fjalë shqip pa gabuar. Në një shtet të tretë më të rëndësishëm mbase nga më të rëndësishmit nga të gjithë u emërua një pijanec i njohur dhe i afirmuar, e kështu me radhë. Miqtë e Shqipërisë dhe persona të paanshëm në përgjithësi duhet të dinë faktin që këta “Përfaqësues” mondanë, bixhosçinj nuk përfaqësojnë Shqipërinë por vetëm disa aventurierë të cilët sot për sot keqqeverisin

Shqipërinë me ndihmën e armiqve të Shqipërisë. (Përkthim nga anglishtja)."

Mund ta lexojmë qartë zhvillimin e personazhit letrar të Denizullu – Serpes, i cili, si modeli më i keq i mundshëm i përfaqësuesit të Zullulandit (dhe jo i Zulluve!) në zyrat europiane të Parisit dhe Londrës, e bëri vendin e tij qesharak në sytë e botës.

II. "Dielli", Cartoon – Nr. 3, datë 3 qershor 1922.
"Si priten shqipëtarët e Amerikës"



"Si priten shqipëtarët e Amerikës"

(përpara katër zyrtarëve të lartë të Shtetit)

- Ekselencia, erdha t'i shërbej Atdheut. Jepmëni një rast të punoj për qytetërimin e Shqipërisë⁶. (Të katër Ekselencat shkulen së qeshuri).

NJË NGA EKSELENCAT

– Ti, hamall i Amerikës, do t'na sjellësh qytetërimin? S'shikon që jemi më të qytetëruar se ti?

⁶ Nënvizimet janë të mijat, për të theksuar afrinë me tekstin e novelës Dr. Gjëlpera zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit.

NJË EKSELENCË TJATËR

-Adimamelenë?

NJË EKSELENCË I TRETË.

-A di turqisht?

NJË EKSELENCË I KATËRT.

-A t'a mban të vrash?."

III. "Dielli", Cartoon – Nr. 27, datë 25 korrik 1923
"Një kuvënt doktorësh në Shqipëri"



"Një kuvënt doktorësh në Shqipëri"

[Duke qenë se oftika, frëngia dhe ethet e kënetave përparojnë në Shqipëri, Guverna thirri një Kuvënt mjekësh për të vendosur masa për të luftuar këto tri sëmundje. Ja ca nga proponimet e të diturve doktorë tanë]:

- Doktor i Parë: Unë proponoj që çdo njeri të jetë i shtrënguar të veshë tri fanella prej leshi; s'ka shpëtim tjetër.

- Doktor i Dytë: Unë thom çdo njeri të pijë çdo mëngjes me pahir tërë jetën e tij një kupë vaj recini.

- Doktor i Tretë: Hajr, Bendenezi jam i mëndjes që oftika, frëngia dhe malaria shërohen me ca **massage** të shtypura prej një ariu të stërvitur.

- Doktor i Katërt: Adam, senda! Gjithë sëmundjet vijnë nga pemët. Le të bëjmë jasak pemët në Shqipëri, dhe s'do të mbetet asnjë i sëmurë.

- Doktor i Pestë: Unë jam i bindur që pjavicat (jahod sylyqet, jahod shushungjet) do t'i çdukim që të tri sëmundjet duke thëthirë ndyrësitë e gjakut".

Diçiturat e dy karikaturave më sipër (Nr. 3 dhe Nr. 27) nuk mund të lënë pa na sjellë shumë afër, pothuajse, të gjithë linjën fabulore që personazhi letrar i Dr. Gjëlperës bën në Shqipëri. Është karakterizimi përmes ligjërimit ai që mundëson transferimin drejt personazheve letrare. Në hapësirën e karikaturës linja fabulore e protagonistit lexohet në katër dialogët që zhvillojnë katër Ekselencat me Shqiptarin e Amerikës, por me një zhvendosje në episodet narrative të prozës letrare.

Fabula nis me përballjen me Ministrin Salembosa, ndryshe këtu, si: “Ekselencia i Parë”, i cili, edhe në veprën letrare, del gjithashtu me formën “Ekselencë”, vazhdon me dialogët mes dy doktorëve “shumë të ditur” të Tiranës, ndryshe “Një Ekselencë Tjetër” dhe “Një Ekselencë i Tretë”, që në vepër po njësoj quhen “Ekselencia”, të identifikueshëm nga i njëjti ligjërimit joshqiptar: - *Adimuamelenë?* - *A di turqisht?*, për të arritur në fund tek polici i doganës me të cilin personazhi i Dr. Gjëlperës, në fakt, u takua në orët e para të zbritjes në Shqipëri, ndërsa, në rastin ku jemi, ai del i fundit në radhë, del si: “Ekselencia i katërt”.

Përmbledhtazi fabula e Dr. Gjëlperës në karikaturë zhvillohet sipas renditjes së personazheve: Ministri, dy doktorët dhe polici. Ndërsa, në novelë, fabula zhvillohet sipas renditjes: Polici, dy doktorët dhe Ministri Salembosë.⁷

Në rastin e diçiturës së dytë (Nr. 27), dy doktorët e novelës rikthehen përmes intertekstit që vjen me dialogët e pesë doktorëve të këtushëm.

Doktori i parë, që përmend rëndësinë e fanellës së leshit për mirëmbajtjen e shëndetit, nuk është gjë tjetër veçse një fragment nga episodi që ndodh mes Dr. Gjëlperës dhe Dr. Emrullahut dhe Dr. Protogoras Dhalla në dhomën e hotelit të Dr. Gjëlperës, teksa dy të fundit, kur shohin Gjëlperën e ri që nuk mban të veshur fanellën e leshit, të zënë në habi, i sugjerojnë ta veshë menjëherë atë, se përndryshe nuk mund ta mbajë gjatë shëndetin e tij.

(Për sa më sipër, po sjellim nga novela referencat intertekstuale):

“Cila është ajo sëmundje tjetër? Pyeti Salembosa”. “Ajo sëmundje, zoti ministër, është shumë e shëmtuar. Më vjen keq që jua thom, po ju qelbet fryma”. – Salembosa shikoi me çudi. “Axgaip! – tha; këtë gja s’ma

⁷ Për efekt krahasimi midis rrëfimit letrar (novela) dhe shprehjes me karikaturë (imazhi) nuk i kemi përmendur të gjitha personazhet që shfaqen në novelë, sepse siç dihet, personazhet e para që takon Dr. Gjëlpera në novelë janë dy doganierët dhe më pas polici, komisari, doktorët, e kështu me radhë.

kish thënë njeri.” Atë gjë mund t’ia thonë njeriut vetëm dy persona: nëna dhe mjeku; të tjerët s’mund ta kenë atë guxim. **Ekselencës**⁸ suaj i qelbet fryma aq fort, sa e ndjeva porsa hyra në odë. Shikova dhëmbët tuaj, nuk keni asnjë të prishur; në gurmaz s’ju gjeta ndonjë plagë: ahëre s’ka dyshim se era e keqe vjen nga përbrenda.” (Dr. Gjëlpera zbulon rrënjët e dramës së Mamuarrasit, f. 130).

“U ulnë. **Efendëm**, - zuri Dr. Emrullahu, - siç ju thashë dhe më parë, jam nxënës i Dr. Habibullah pashait, - dhe meqë Dr. Gjëlpera s’bзënte, - **i meshhur Habibullah pashait!**”- shtoi Dr. Emrullahu, duke i rënduar zërit me fjalën ‘Meshur’ dhe duke shikuar Dr. Gjëlperën me kryelartësi mu në fund të syve. – ‘Nuk e kam dëgjuar emrin e tij kurrë’, tha Dr. Gjëlpera. – Si? Kurrë? Pyeti Dr. Emrullahu i habitur. – ‘Kurrë!’ ktheu Dr. Gjëlpera. – ‘Ha-ha-ha-ha! **’Ne axhaip!’** qeshi Dr. Emrullahu, dhe duke i folur një grupi kumarxhinjsh, **’Arkadashllar’ tha, ‘buna bakiniz. Dr. Habibullah pashanen ismini bile ishtimemish’,** dhe qeshi përsëri”. (Dr. Gjëlpera zbulon rrënjët e dramës së Mamuarrasit, f. 118).

“Në qoftë, zoti doktor, se ambicia juaj është **të vrisni nonjë njeri**, ose disa njerëz, do t’ju kushtojë gjashtëdhjetë napolona për krye”. (Dr. Gjëlpera zbulon rrënjët e dramës së Mamuarrasit, f. 111).

“Kur Dr. Gjëlpera vuri këmishën e brëndshme prej liri dhe pa mëngë, edhe brekët të shkurtra gjer më gju tërë prej liri, dhe pastaj mori këmishën e ditës, Dr. Emrullahu bashkë me Protagoras Dhallën bënë një bërtrim çudie. “Aman, zoti doktor, - tha Dr. Emrullahu, **s’paskeni fanellë?**” **“Ç’fanellë?** Ç’doni të thoni?” pyeti Dr. Gjëlpera i habitur. – “Këmishë prej fanelle, qirie jatре; do të plevitoseni”, bëri Dr. Dhalla. – “Aman, zoti doktor, **pa fanellë si mund të rrojë njeriu?**”, vazhdoi Dr. Emrullahu. Dr. Gjëlpera i shikoi me një sy të çuditur; - “Pse ju mbani fanellë?”- pyeti, (...).” (Dr. Gjëlpera zbulon rrënjët e dramës së Mamuarrasit, f. 162).

Imazhi që i caktohet në karikaturë “Shqiptarit të ri të Amerikës”, është shëmbëlltyra e të riut Gjëlperë, me trup të gjatë, të drejtë, elegant. Dallon menjëherë nga sfondi shqiptar i Ekselencave të tryezave të pista të mejhaneve nga shëndeti i paqme, higjiena e pastër, kostumi modern që ka veshur, këpucët, palltoja dhe kapelja që mban në duar, nga zgjuarsia që i lexohet në tiparet e fytyrës dhe gjestikulacioni, ndërsa u drejtohet doktorëve në tavolinë.

⁸ Të gjitha fjalët e nënvizuara janë të miat, - L. L.

Por, rasti më domethënës, i cili do të marrë edhe fokusin tonë të posaçëm në këtë pjesë të punimit, është ai i personazhit të mirënjohur, Ministrit Salembosë, në novelën *Dr. Gjëlpera zbulon rënjët e dramës së Mamurrasit*.

Personazhi letrar i Ministrit Salembosë u duk për herë të parë në shtyllat e “Diellit” në datën 30 gusht, kur botohej numri 6 i novelës *Dr. Gjëlpera zbulon rënjët e dramës së Mamurrasit*. Është ky Ministër, ose ndryshe, koka e organizatës së Kamorrës, që vepron në shoqërinë shqiptare gjatë viteve 1920, më saktësisht gjatë vitit 1924. Emri i është krijuar nga kompozita e një pijeje orientale⁹, për ta personifikuar si një figurë me mentalitet joperëndimor, përkrahës të injorancës, prapambetjes dhe korrupsionit shtetëror.

Për sa kohë është e pranuar nga kritika që merret me artin e karikaturës se ato (karikaturat) mund të jenë fyese ose komplimentuese, mund të shërbejnë për një qëllim politik apo të merren vetëm për argëtim, se karikaturat e politikanëve përbëjnë një fakt të mirënjohur për përdorimin e madh, që kanë pasur në politikën editoriale të gazetave etj., mund të pohojmë se një Salembosë në mjedisin shqiptar të 1920-ës mund të ishte, jo vetëm personi i Ahmed Zogut, Ministër i Punëve të Brendshme asokohe, por çdo ministër tjetër apo politikan i akuzuar hapur nga Konica, i cili përkrahte frymën orientale, duke penguar ecjen e Shqipërisë në ritmin e kohës europiane. Për shembull, një Salembosë mund të ishte fare mirë personi i Eshref Frashërit, të cilin Konica, gjithashtu përmes karikaturës, edhe publicistikës, e ka goditur fort vazhdimisht.

Por Ministri Salembosë, që jepet përmes imazhit dhe tekstit në dëgjuesin e karikaturës, identifikohet plotësisht me personin e Ahmed Zogut dhe me asnjë tjetër figurë historike shqiptare. Ky personazh ka rëndësi të dorës së parë për analizën tonë, sepse, siç do ta shohim më poshtë, ai merr dhe jep në referenca me veprën letrare duke e saktësuar simbolikën e personazhit letrar në figurën konkrete, që autori ka synuar që në fillim.

Ministrin Salembosë, në fakt, Konica e sjell tek lexuesi më përpara me karikaturën se me tekstin letrar *Dr. Gjëlpera zbulon rënjët e dramës së Mamurrasit*. Karikaturat tek gazeta “*Dielli*” fillojnë që më 1923, ndërsa novela nis të botohet vetëm më 16 gusht 1924. Lexuesi, pra, ka krijuar kontakt me këtë personazh më parë se ta krijojë me tekstin letrar. Nuk janë të pakta karikaturat që na sjellin imazhin dhe situatat e kësaj figure.

⁹ Xh. Lloshi, në: KONICA, Faik. (2001). *Vepra 5, vep. e cit. f. 292.*

Shërbejnë veçanërisht diçiturat si pjesë përbërëse, - ato që përkthejnë në gjuhë imazhin e ndërtuar me vizatim, të cilat, duke e trajtuar figurën në situata të ndryshme nuk mund të mos krijojnë për lexuesin një përshtypje të caktuar, e cila, gjithsesi, shmang për lexuesin historik, aq më tepër për atë bashkëkohor, leximin e qetë dhe të pandikuar.

E para karikaturë që i kushtohet drejtpërdrejt Ministrit Salembozë i takon muajit prill 1923. Këtu e kemi fjalën për ato karikatura tek të cilat personazhi shfaqet i plotë në emërtim, pra, del në formën e “Ministrit Salembozë”, ndërsa në forma të tjera sinonimie, të dhëna me emërtime jo të plota, siç janë format me: Ministri, Ekselencia etj., karikaturat e personazhit shfaqen që në vitin 1922.

Më poshtë po sjellim rrugëtimin e plotë të personazhit përmes kësaj teknike të shprehuri në gazetën “Dielli” për të parë se si Konica jep vlerësimin e drejtpërdrejtë mbi të.

Rasti 1:

“Dielli”, Cartoon – Nr. 19, datë 27 janar 1923.

“Populli i shtypur dhe i kënaqur”



“Populli i shtypur dhe i kënaqur

Një “Ministër”¹⁰ dhe një “General” kuvëndojnë duke pirë salep, dhe duke bërë sehir Popullin plak, të ngarkuar me vergji gjer sa i del shpirti.

Ekselencia e Parë. Shiko sa i kënaqur është populli.

Ekselencia e dytë. Është popull i ndershëm. I duron të gjitha, është i lumtur, s’qahet.

Eks. 1. Dhe ka ca vagabond që thonë se Populli vuan dhe se duhet t’i lehtësohet barra.

Eks.2. Ata janë njerëz të shitur. Për fat të mirë s’ua vë njeri veshin.

Eks.1. Spiunët që kemi gjetur në mes të pojakëve e të rajave na ndihin shumë.

Eks. 2. Dush – manëmëz inshallah mahv ollur.

Eks.1. Amin.”

Rasti 2:

“Dielli”, Cartoon – Nr. 22, datë 21 prill 1923.

“Ekselencat inspektojnë uniformat e ra t’ushtarëve”



¹⁰ Nënvizimet për fjalët “Një Ministër” dhe “salep” janë të miat, për të dalluar objektin e analizës ku jemi, - L. L

“Ekselencat inspektojnë uniformat e ra t’ushtarëve

Min. Salemboza¹¹. – Ju uroj, General, për bukurin’ e uniformave që prutë.

Gen. Tum. – Falem nderit, **Z. Ministër**. Unë s’bëra veç se detyrën time.

Min. Salemboza. – Jini tepër i përulët, General. Bëtë më tepër se detyrën. Tani pa dyshim do t’vërtetohet fjala që thosh një nga larot e pëndës që paguaj unë.


Gen. Tum. – Cila ishte fjala e laros, **Z. Ministër**?

Min. Salemboza. – Fjal’ e tij ish që kur të vijnë uniformat nga Parisi, çpifarakëve do t’u çkuqen faqet nga turpi”.

Rasti 3:

“Dielli”, Cartoon – No. 24, datë 12 maj 1923.

“Ministria qëndron në themele të shëndosha”



“Ministria qëndron në themele të shëndosha

¹¹ Nënvizimet janë të miat. Të gjitha nënvizimet e këtij lloji në vazhdim janë bërë nga unë, - L. L.

“Kabineti” që e çqeveris Shqipërinë mburret se qëndron në themele të shëndosha. Po, pa fjalë. Ato themele aqë të shëndosha janë mustaqet e Napoleonit të Gjirizave ve. Minsitri Salemboza na shfaqet akrobat i mbaruar. Po në qoftë se Napoleoni i Gjirizave lëviz pak kryet?...”

Diçitura e mësipërme ka rëndësi të posaçme në analizën tonë, sepse ndërftuar në tekst një tjetër pseudonim aktiv në botën e figurave publicistike, por edhe letrare të Konicës, duke realizuar në këtë mënyrë identifikimin e dy figurave tek njëra-tjetra. Përmes dy fjalive dëftore, ku e dyta është dhënë me një pyetje retorike (dy kryefjalët respektive të secilës fjali ndërtohen nga pseudonimet që lidhin të njëjtin person të historisë shqiptare), realizohet identifikimi i Napoleonit të Gjirizave me Ministrin Salembozë dhe, të dy bashkë, me figurën politike të Ahmed Zogut.

Ministri Salemboza na shfaqet akrobat i mbaruar. Po në qoftë se Napoleoni i Gjirizave lëviz pak kryet?...

Nga ana kompozicionale karikatura e bën njësimin e personazheve sipas rendit të vendosjes së tyre tek njëri-tjetri, sipas aksit vertikal, me drejtimin poshtë – lart. Këmbët e Ministrit Salembozë qëndrojnë të mbështetura mbi mustaqet e Napoleonit të Gjirizave, duke dhënë idenë e vazhdimësisë së simbolikës nga figura e dytë tek e para. Ndaj, mund të konkludonim lehtësisht se ecja e figurave shkon nga Napoleoni i Gjirizave tek Ministri Salembozë për t’u përmbledhur tek Ahmed Zogu.

Por, nga ana tjetër, Napoleonit të Gjirizave, Konica i ka dedikuar një karikaturë më vete, tetë numra më parë se kjo ku jemi dhe, konkretisht në 27 dhjetor 1922.

“Dielli”, Cartoon – No. 16, datë 27 dhjetor 1922.
“Napoleoni i Gjirizave”



“Napoleoni i Gjirizave

“Napoleoni i gjirizave flet, - Flet Napoleoni i Gjirizave - flet dhe thotë:

- Sa të jem unë i gjallë, Shqipëria është e shiguruar nga çdo rezik. S’u a kam frikën armiqve të Kombit. Një të treguar unë dhëmbët, dhe të gjithë do t’ikijnë me vrap. Jam i zoti me një kaikë të zë Sazanin; dhe po të më zemërojnë shumë, zbres edhe në Taranto dhe e shkel tër’ Italinë, në mos me këmbë po me automobil, ose të pakën me tren.

Po ku të lënë myxyrat, njerëzit e shitur dhe vagabondët? Ah tradhëtorë, tradhëtorë! Unë jam mëmëdhetar, kam vdekur disa herë dhe do të vdes përsëri për mëmëdhenë!”

Rasti 4:

“Dielli”, Cartoon – No. 26, datë 20 qershor 1923.
“Gjakpirësit e popullit”



“Gjakpirësit e popullit

Ministri Salemboza dhe **Generali Tum**, kafshë misterioze të natës, i thëthijnë pa mëshirë gjakun Popullit. Shikoni sa është ligur dhe dobëtuuar populli! Gjer kur vallë martirizimi i tij?”

Rasti 5:

“Dielli”, Cartoon – No.30, datë 15 shtator 1923.

“Fryma e dallkaukëve dhe vota e popullit”




“Fryma e dallkaukëve dhe vota e popullit

Dallkaukët me lëvdatat e tyre ja frynë aq shumë barkun Ministrit Salemboza sa Ekselenca e Tij arrin të besojë edhe vetë se është me të vërtetë i madh dhe me rëndësi. Po bujku, me dobecin e votës, i çpoi pakë barkun Salembozës; dhe shikoni! Tërë era dolli jashtë duke çfaqur proporcjen e vërtetë të trupit Salembozor”.

Rasti 7:

“Dielli”, Cartoon – No.31, datë 13 tetor 1923.

“‘Shqipëria’ emëron konsull në Grenland”



“‘Shqipëria’ emëron konsull në Grenland

Kabineti i Tiranës ka nderuar me emërtime jashtë, fjala vjen në Belgrad.

Dëmi që i bëhet Shqipërisë si dhe karakterit t’atyre përfaqësuesve të ndershëm që kemi në disa vende, s’merret në sy fare. Tani shpejt **Ministri Salemboza** qënka pjekur me një diplomat nga Sing Sing College – it dhe u kënaq aq shumë nga ditari i tij sa e emëroi Konsull në Grenland, nisi e madhe e Danmarkut. Në kartun, **Salemboza** gostit me salep Zotin Konsull duke pritur që Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë të gatitë kredencialet.”

Rasti 8:

“Dielli”, Cartoon – No.35, datë 18 dhjetor 1923.
“Salemboza jep një fjalë elektorale”



“Salemboza jep një fjalë elektorale”

Ministri Salemboza i thotë Popullit: ‘I kam shërbyer Sërbisë me besnikëri. Kam bërë marrëveshje me Epiriotët. Kam vrarë njerëz të pafajshëm. Kam plaçkitur arkën e shtetit. Kam fëlliqur patriotët. Kam ngjallur sistemin e spiunëve. Kam shtrydhur gjakun e bujkut. Kam mbyllur shkolla. Kam shkelur lirinë e shtypit. Kam demoralizuar vëndin. Kam lënë shqiptarët përtej kufirit të vdesin urie. E kam bërë Shqipërinë gesharake, dhe kam vënë indipendencën e saj në rrezik. Prandaj duhet të më jipni besim dhe votë, që të mbetem në fuqi gjër sa ta prish Shqipërinë fare dhe t’i lë shqipëtarët udhëve!’.

Rasti 11:

“Dielli”, Cartoon – No.40, mars 1924.

“Minstri Salemboza dhe ushtëria”



“Minstri Salemboza dhe ushtëria”


Ushtëria shqiptare (**Salembozës**): - Do t'a lesh me të mirë ofiqin, apo do të na shtrëngosh të përdorim sungjitë që ta nxjerrim jashtë?

[Shënim i Managerit të “Diellit” – Ndonëse kartunet e Gazetës s’kanë qëllim stërvitje politike e sociale dhe s’kanë kurrë karakter mërie personale, prapë nuk do ta kishim botuar kartunin e sotëm në një kohë **kur njeriu i karikaturuar, Z. Ahmed Zogu, është** i plagosur në shtrat, po të mos qenë dy fakte: I pari fakt, që kartuni u – porosit dhe u – mbarua prej artistit një javë përpara atentatit; i dyti fakt që viktim’ e atentatit vete mirë dhe është jashtë çdo rreziku.]”

Rasti 13:

“Dielli”, Cartoon – No. 41, datë 18 mars 1924.

“Pyetje: Sa peshon Populli përpara interesave personale”



“Pyetje: Sa peshon Populli përpara interesave personale”

VDEKJA përgjigjet: - Lakmitë personale, çandat ministeriale, ofiqet, peshojnë shumë më tepër se sa populli. Në mos besoni, ja tek i kam shtënë në ballancë!

(shënim i “Diellit”.— VDEKJEN duhet ta besojmë, se ajo pa fjalë dëshëron që Shqipëria ta ketë jetën të gjatë. Po vini re se si VDEKJA bën hile me qishtin dëftonjës të dorës së mëngjër¹²! Vallë është e drejtë ballanca?)

¹² Është i njëjti veprim që bën Ministri Salemboza në novelën Dr. Gjëlpera zbulon rënjtë e dramës së Mamurrasit: “Salemboza ngriti kokën me kryelartësi, krojti përsëri ballët me qishtin dëftonjës të mëngjër dhe afroi cazë fronin”, f. 128.

Në karikaturat që botohen pas muajit mars 1924, bie në sy një ndryshim në emërtimin e personazhit kryesor, sepse nuk përdoret më emri i personazhit të Ministrit Salembosa për të referuar Ahmed Zogun, por përdoret hapur emri i vetë personit: - Ahmed Zogu, Ahmed Zogolli, Zogolli apo Zogolloviç.


Këtë ndryshim në përdorim të emërtimeve mund ta interpretojmë për shkak të vendosjes së komunikimit të tekstit letrar me lexuesin (periudha gusht – nëntor 1924). Tashmë, Ministri Salembosa, flet me lexuesin e tij nga bota e tekstit letrar, që është i pozicionuar në faqet e brendshme të gazetës “Dielli”, ndërsa, kryefaqja e gazetës i lejon lexuesit më shumë drejtpërdrejtshmëri dhe më pak interpretim për informacionet që jep.

Emri i personazhit rikthehet pak herë, në dy raste, në datat 30 shtator 1924 dhe 13 janar 1925; në të parin rast, takon me kohën kur novela shkruhej njëkohësisht në shtyllat e “Diellit” (diçitura “Salembosa përgjon për së largu”) dhe, në të dytin rast, kur novela e kishte pushuar botimin e saj (diçitura “Faji, dhe pastaj mësimi”).

Rasti 14:

“Dielli”, Cartoon – No. 48, datë 1 korrik 1924.

“Fluturimi i Zogut më të shpejtmë të Shqipërisë”



“Fluturimi i Zogut më të shpejtmë të Shqipërisë”

[Ahmed Zogolli, kur e ndroi llaqapin dhe e bëri Zogu, dinte se ç'bënte: dinte se kish për t'ardhur një ditë që do t'provonte se qe jo vetëm me të vërtet një zog, po dhe zogu më i shpejtmë i tërë Shqipërisë. – Kartoni që botojmë sot, na tregon Zogun që po fluturon duke kënduar shqip, arabisht dhe sërbsisht]:

Zogu. – o nan, u – fika! S'paskam asnji meejk! Edhe gjuurt i paskam kundra! Ja – allah, merhamë. Bozhe milosrdje! Gospodine Pashiç, pomoç! Pomoç! Po – moç! Po – moç! “

Rasti 15:

“Dielli”, Cartoon – No. 50, datë 29 korrik 1924.

“Ahmedi kurorëzohet mbret në Serbi”



“Ahmedi kurorëzohet mbret në Serbi

(Më në fund u – vërtetuan ëndërrat e Ahmed Zogollit. Duke shëtitur nëpër Sërbi, idealisti shqiptar ra në mes të një kopeje derrash të cilët e aklamuan duke përpjekur këmbët, i vunë një kurorë hudhërash në krye edhe thirrën ‘Rroftë Tsari i Shqipërisë’.

*Derrat (duke trokitur këmbët). – Zhivio albanski Tsar, **Ahmed Zogollovic!***

Rasti 16:

“Dielli”, Cartoon – No.54, datë 30 shtator 1924.

“Salemboza përgjon për së largu”



“Salemboza përgjon për së largu”

Salemboza. – (Duke shikuar me “dylbi”, monologon me zë të mallëngjyer:) Shoh një gjallësi të madhe në Shqipëri. Në qoftë se qeveritarët e rinj punojnë me të vërtetë, mua s’do t’më mbetet më asnjë shpresë. Do të kalbem në mërgim...


(Pas një çasti, vazhdon me zë më të gëzuar:)

S’kisha parë mirë. Kisha marë për gjallësi dhe veprim lëvizjet e duarve dhe bërtimet e tyre. Ahere paska shumë shpresë për mua!.”

Rasti 17:

“Dielli”, Cartoon – No. 62, datë 13 janar 1925.

“Faji, dhe pastaj mësimi”



“Faji, dhe pastaj mësimi

SALEMBOZA (Generalëve Pagur dhe Barbut). – Përpjetë duart! Hasha, pijit dhe luajit kumar, eh? Duhet të dijit se të pirët dhe bixhozi s’janë gjëra të mira për luftarët. Më ka parë njeri mua të pi ose të loz? As pi, as loz. Andaj ju zura. Po n’atë fron ç’kini vënë mi hartën e Shqipërisë?

GENERALI BARBUT. – Ca djathë, **Ekselencë**.

GENERALI PAGUR. – Për meze, **Ekselencë**, për meze.

SALEMBOZA. – Po harta është për të studiuar, Zotërinj, jo për të pështjellë mezero. Të ishit kujdesur më tepër ta studiojit hartën e Shqipërisë, ndofta nuk do t’ju kisha zënë kaq lehtë. Oficerë dhe kumar, dhe raki, dhe meze të pështjellë me kartën e shtabit! Këto faje kundër shtetit duan një punitje. Bini në gju dhe lëpimëni opingat, ose billahi i shkrepa koburet!”

Ndryshimi i fundit që duam të vëmë në pah në ecurinë e trajtimit të personazhit të Ministrit Salembosa, ndryshe Ahmed Zogut, në karikaturë, po bashkë më të edhe në trajtimin letrar, sidomos reflektuar kjo tek teksti *Shqipëria si m’u - duk*, është momenti i “ngritjes së kultit të individit”, ku

duket hapur adhurimi i hiperbolizuar që në disa vende Konica bën për figurën e Mbretit të Shqipërisë, ndryshe Zogu I.

E njëjta logjikë trajtimi përdoret edhe në karikaturë. Pas janarit të vitit 1925 karikatura e Zogut/Ministrit Salembosa pëson ndryshim të plotë në qasje. Ministrit Salembosa ia kanë hequr të gjithë rekuizitën komike të portretit të deritashëm: - dy opingat e kthyer me majë të gjatë, benevrekët e malësorit, ku spikat e bardha dhe e zeza, xhakëtën ku mban të varura në kraharor dy medalje, një për secilën anë, dylbinë e gjatë përmes së cilës mund të kontrollonte për së largu të gjitha lëvizjet që bëheshin në Shqipëri, enën e salepit, pijen e tij të preferuar, që nxjerr avuj të nxehtë, mbajtësen e vogël në formën e tabakasë, që i qarkon belin në të cilën qëndrojnë gati për shërbimin e Salepit tre filxhanë, garuzhden e madhe kokëvarur, koburen emblematike, të strukur pas tabakasë, në kontakt me barkun, mustaqet komike dhe dhëmbët e krimbur, për t'ia zëvendësuar të gjitha këto me kostumin elegant europian të udhëheqësit të duhur, me kapelen, këmishën e pastër e kravatën që i rri mbërthyer fort bukur pas qafës, si dhe me këpucët e kohës. Elementi i fundit, por jo më i parëndësishëm në këtë portret, është puroja e ndezur mes gishtërinjve të dorës së djathtë që i shkon për shtat këtij burri shteti të zgjuar e të transformuar vizualisht. Çdo gjë që rrethon tani figurën e Zogut i përket frymës perëndimore dhe transmeton vetëm hijeshi dhe bukuri estetike.

Për Roland Barthes-in kuptimi i të veshurit është tregues i shkallës së përfshirjes së një individi në rregullat shoqërore, dhe e "konsideronte veshjen një fakt shoqëror fort të rëndësishëm të cilën e analizoi përmes semiologjisë që u quajt nga ai e nevojshme si në veçanti, për të përcaktuar natyrën e vërtetë të veshjes, ashtu edhe në përgjithësi për të kuptuar dhe shpjeguar një numër të madh dukurish shoqërore."¹³ Pra, "veshja ka një formë të vetën (objekt i estetikës dhe teknologjisë), por ka edhe funksione (subjekt i kërkimit kulturor)".¹⁴

Tek personazhi letrar i Ministrit Salembosë, funksioni i veshjes është përfshirja e personazhit në struktura të reja shtetërore dhe shoqërore, që orientohen tashmë nga të tjera kritere vlerësimi. Veshja e personazhit, përveçse përcakton një status të caktuar, të ri dhe të rëndësishëm në hierarkinë e shtetit shqiptar, tregon për lexuesin edhe botën e vlerave që

¹³ Shih: G. Marrone (2008). *Trupat shoqërore. Proceset komunikuese dhe semiotika e tekstit*. Përkthyer: Dhurata Shehri dhe Persida Asllani. Tiranë, Botimet Dudaaj, f. 41-66.

¹⁴ G. Marrone. *Vep. e cit. f. 49*.

përfaqëson personazhi i transformuar. Veshja e tij është kuptimplote dhe përforcon epërsinë në statusin shtetëror dhe moral, që përfaqëson Ahmed Zogu në sytë e Faik Konicës. Prandaj është e natyrshme, që të largohet Salembosa që *“kruante ballët pas dritares me gishtin dëftonjës të dorës së mëngjër”* dhe të vijë Ahmet Zogu, i veshur elegant, ulur këmbë mbi këmbë, me cigaren mes gishtërinjve që kuvendon si një zotëri i vërtetë, ose, në ndonjë rast tjetër, të vijë në imazhin e strategut të suksesshëm, i veshur me parzmore, që e përdor shpatën ndaj kundërshtarit me lehtësi të lexueshme, shenjues që vënë në pah epërsinë e kësaj figure të ngritur.

Tek *Shqipëria si m'u - duk* evoluimin e personazhit letrar të Ministrisë Salembosë e gjejmë të trajtuar plotësisht në Kapitullin II, që është titulluar nga vetë Konica: *MBRETI*. Është kapitulli ku Konica përdor gjuhën më lavdëruese për të përshkruar figurën e Mbretit Zog, adhurimin që ai ndjen për të, për veprat e Mbretit dhe për inteligjencën e tij të rrallë, për ta përmbyllur në shprehjen hiperbolizuese, në të njëjtën kohë shumë të diskutueshme edhe sot: “Filizit të fundmë të lisit të madh ilirian”. (*Shqipëria si m'u - duk*, f. 42).


Shqipëria si m'u - duk, siç e dimë, u shkrua në vitin 1929, ndërsa grupi i ri i karikaturave në linjën e Presidentit Zog janë krijuar pas shtatorit 1925. Edhe në këtë rast, karikatura e personazhit ka paraprirë tekstin letrar. Ajo ka krijuar tek lexuesi i gazetës “Dielli” një lloj orientimi kontekstual dhe imazhi për personazhin që do të vijë më vonë në kohë, afërsisht katër vite më vonë, përmes prozës eseistike.

Në grupin e ri të karikaturave (atë të pas janarit 1925), imazhin e Zogut e gjejmë tri herë dhe të shënuar me emrin e tij, si: Ahmet Zogu, Zogu, Presidenti Zogu. Pjesën tjetër të kohës dhe të interesit të Faik Konicës, si bashkëprodhues i artit viziv përmes karikaturës do ta zëre personazhi i “Mjekrës”, ndryshe, analogu historik Fan Noli.

Rasti 1:

“Dielli”, Cartoon – No. 77, datë 20 tetor 1925

“Lodra më e vjetër e botës”



“Lodra më e vjetër e botës

ZOGU (I flet Nolit duke qeshur): **LODRA MË E VJETËR E BOTËS**
-Miku im, jam gati të bëj bast sa të duash që jo vetëm nuk më ngre dot, po nukë munt as të më luash pak nga vëndi.
(Shënim. – Kjo karikaturë ish porositur dhe mbaruar disa ditë përpara shpalljes së amnistisë).”

Rasti 2:

“Dielli”, Cartoon – No. 83, datë 9 shkurt 1926.

“Goditje dhe përgjigje”



“Goditje dhe përgjigje

Në pjesën e parë të Kartunit **Presidenti Zoqu** (i veshur me hekur si një kalorës i Kohës së Mesme) bën sehir një grup kundërshtarësh që e kanë rrethuar dhe po e goditin me çfarëdo mënyre. Në pjesën e dytë **Presidenti Zoqu** u kthehet me grusht të hekurt duke u thënë: “Tani është radha ime. Të shohim kush është më i fortë?”

Përmes teknikës së karikaturës, një teknikë moderne, jo vetëm për gazetarinë shqiptare, por edhe për atë europiane e botërore të asaj periudhe, me efikasitet të lartë falë aftësive referuese që i jep imazhi, në fakt, Konica na mundëson identifikimin e plotë të personazhit letrar që jeton në tekstin e novelës dhe na lejon të analizojmë transformimet (zgjerimin dhe ngushtimin në përmbajtje) që ky personazh ka pësuar nga autori në një periudhë të caktuar kohe. Efekti i reales¹⁵ nuk vepron

¹⁵ Term i Barthes – it.

asnjëherë më mirë se në rastin kur ushqehet nga aparenca¹⁶ dhe në këtë rast, falë këtij efekti që ka veçanërisht novela *Dr. Gjëlperëa zbulon rënjët e dramës së Mamurrasit* me kontekstin historik shqiptar, detajeve domethënëse, që evokon Konica, u shtohet një e dhënë më shumë, duke e ndihmuar lexuesin në përcaktimin dhe interpretimin e mjedisit të veprës letrare dhe aktorëve veprues.

Edhe në karikaturë ruhet i njëjti brumë ligjërimor i Konicës shkrimtar, spikatin ironia dhe humori teksa përqesh e vë në lojë probleme të qenësishme të shtetit dhe shoqërisë shqiptare.

BILBIOGRAFI

- Barthes, R. (1989). *The rustle of language* (Translated by Richard Howard). California. University of California Press.
- Chartier, P. (2015). *Hyrje në teoritë e mëdha të romanit* (përktheu. Gjovalin Kola). Tiranë, Onufri.
- Konica, F. (2013). *Karikatura në gazetën "Dielli" (20.5.1922 – 3.9.1926)*, (Mblodhi, përgatiti dhe pajisi me shënime Efthim Dodona).
- Konica, F. (2001). *Vepra 1 – 5*. (Zgjedhur e përgatitur nga prof. Nasho Jorgaqi). Tiranë, Dudaj .
- Lloshi, Xh., *Stili i Faik Konicës në: KONICA, Faik. (2001). Vepra 5*.
- Marrone, G. (2008). *Trupat shoqërorë. Proceset komunikuese dhe semiotika e tekstit*. Përkthyer: Dhurata Shehri dhe Persida Asllani. Tiranë, Botimet Dudaj.
- The Routledge Dictionary of Literary Terms*. Routledge Press, London and New York, 2006.

¹⁶ P. Chartier (2015). *Hyrje në teoritë e mëdha të romanit*, (përktheu Gjovalin Kola). Tiranë, Onufri, f. 119.

